



UK Health
Security
Agency



Udhëzues për vaksinimet **në moshën një vjeç**



**Veçoritë e programit të vaksinimeve
nga shtatori 2024**

immunisation

the safest way to protect your child

Programi i vaksinimit të fëmijëve

Mos harroni të merrni me vete librin e kuq të vaksinimit në çdo takim.



Mund të gjeni kopje të këtyre broshurave në klinikë ose te zyra e mjekut. Shikoni gjithashtu **www.nhs.uk/vaccinations**

Kjo broshurë përmban programin e vaksinimit nga shtatori 2024

Përmbledhje

Cilat vakcina do të bëjë fëmija im në moshën një vjeç?

Fëmija juaj do të bëjë 4 injeksione në vizitën për vaksinimin në moshën një vjeç, ku përfshihen:

- vakcina përforcuese **MenB**
- Një vaksinë **Hib/MenC** kundër:
 - Hib (Haemophilus influenzae tipi b), dhe
 - sëmundja meningokokale e grupit C (MenC)
- një vaksinë përforcuese **PCV13** kundër:
 - sëmundjes pneumokokale të shkaktuar nga disa lloje të baktereve pneumokokale
- vakcina e parë **MMR** kundër:
 - fruthit
 - shytave
 - rubeolës



Vaksinimet në moshën një vjeç

Mbrojtje nga Hib, sëmundjet meningjokokale të grupeve B dhe C, sëmundja pneumokokale, fruthi, shytat dhe rubeola

Çfarë është Hib?

Hib është një infeksion që mund të shkaktojë shumë sëmundje të mëdha, si meningjit (inflamacion i cipës së trurit), septicemi (helmim i gjakut) dhe pneumoni, sidomos te fëmijët e vegjël.

Vaksina Hib/MenC quhet Menitorix, mund të shihni fletushkën e informacionit për pacientin në www.medicines.org.uk/emc/product/167/pil.

Çfarë është sëmundja meningjokokale?

Sëmundja meningjokokale është një infeksion i rëndë që mund të shkaktojë meningjit dhe septicemi te fëmijët dhe të rinjtë.

Aktualisht, bakteret meningjokokale të grupit B (MenB) janë përgjegjëse për shumicën e rasteve të sëmundjes meningjokokale në Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa sëmundja meningjokokale e grupit C (MenC) tani ndodh rrallë sepse shumica e të rinjve dhe adoleshentëve vaksinohen rregullisht kundër MenC.

Vaksina kundër MenB quhet Bexesero, mund të shihni fletushkën e informacionit për pacientin në www.medicines.org.uk/emc/product/5168/pil.

Cila vaksinë do të përdoret?

Fëmija juaj do të ketë një dozë të vaksinës Hib/MenC të kombinuar, si edhe një dozë përforcuese të një vaksine MenB. Këto vaksina do të jepen në muskulin e kofshës ose të pjesës së sipërme të krahut.

Pse ka nevojë për vaksinë përforcuese fëmija im?

Vaksinat përforcuese jepen për të rritur mbrojtjen e marrë tashmë nga vaksinat që fëmija juaj ka bërë më parë. Mbrojtja e ofruar nga vaksinat për foshnjat mund të dobësohet me kalimin e kohës. Doza përforcuese zgjat më tej periudhën e mbrojtjes gjatë jetës.

A do të kenë ndonjë efekt anësor vaksinat kundër Hib/MenC dhe MenB?

Fëmija juaj mund të ketë skuqje, ënjtje ose ndjeshmëri në vendin ku bëhet injektimi. Rreth gjysma e fëmijëve që kanë bërë këto vaksina mund të irritohen lehtë, dhe disa mund të kenë pak temperaturë. Mund të merrni më shumë informacion lidhur me këtë te mjeku i përgjithshëm, infermieri ose vizitori i shëndetit.



Çfarë është sëmundja pneumokokale?

Sëmundja pneumokokale është një nga shkaqet më të shpeshta të meningjitit bakterial te fëmijët, por shkakton edhe septicemi, pneumoni, infeksione veshi (otitis media) dhe sëmundje të tjera të rënda. Ekzistojnë më shumë se 90 lloje të ndryshme të baktereve pneumokokale.

Cila vaksinë do të përdoret?

Vaksina e përdorur është një dozë përforcuese e PCV13 (vaksina e konjuguar pneumokokale) e cila mbron nga 13 lloje të ndryshme pneumokokale që shkaktojnë më shpesh sëmundjen pneumokokale te fëmijët. Kjo vaksinë do të bëhet në muskulin e kofshës ose të pjesës së sipërme të krahut në të njëjtën vizitë me vaksinat kundër Hib/MenC dhe MenB.

A do të ketë vakcina PCV ndonjë efekt anësor?

Nga 10 foshnjat e vaksinuara, 1 ose 2 mund të kenë pak ënjtje, skuqje ose brishtësi në vendin e injektimit ose mund të kenë pak temperaturë. Vaksina PCV quhet Prevenar 13, mund të shihni fletushkën e informacionit për pacientin në www.medicines.org.uk/emc/product/453/pil.

Çfarë është fruthi?

Fruthi shkaktohet nga një virus shumë infektiv. Pothuajse kushdo që infektohet do të ketë temperaturë të lartë, skuqje dhe në përgjithësi nuk do të ndihet mirë. Komplikacionet e fruthit përfshijnë infeksione në gjoks, kriza (konvulsione), encefalit (infeksion i trurit) dhe dëmtim i trurit. Në raste shumë të rënda, fruthi mund të shkaktojë vdekje.

Çfarë janë shytat?

Shytat shkaktohen nga një virus i cili mund të shkaktojë temperaturë, dhimbje koke dhe dhimbje e fryrje të gjëndrave të fytyrës, qafës dhe nofullës. Mund të shkaktojë shurdhim të përhershëm, meningjit viral dhe encefalit (inflamacion dhe ënjtje e trurit).

Çfarë është rubeola?

Rubeola (fruthi gjerman) është një sëmundje që shkaktohet nga një virus. Te fëmijët është zakonisht i lehtë dhe mund të kalojë pa u vënë re, por rubeola gjatë shtatzënisë është shumë e rrezikshme për fëmijët në bark. Mund të dëmtojë rëndë shikimin, dëgjimin, zemrën dhe trurin. Kjo sëmundje quhet sindroma e rubeolës kongjenitale (CRS).

Çfarë është vakcina MMR?

Përmban versione të dobësuara të viruseve të gjalla të fruthit, shytave dhe rubeolës. Ngaqë viruset janë dobësuar, njerëzit që kanë bërë vaksinën nuk mund të infektojnë njerëz të tjerë. Në Mbretërinë e Bashkuar kemi 2 vakcina MMR. Të dyja funksionojnë mirë; njëra përmban xhelatinë derri dhe tjetra jo. Nëse doni që fëmija juaj të bëjë vaksinën që nuk përmban xhelatinë derri, flisni me infermierin ose mjekun e përgjithshëm.

Si dhe kur bëhet vakcina?

Vaksina injektohet në muskulin e kofshës ose të pjesës së sipërme të krahut. Bëhet në moshën një vjeç pas imunitetit që fëmija ka marrë nga nëna dobësohet. Një dozë e dytë e vaksinës duhet të jepet përsëri para se fëmija të fillojë shkollën rreth moshës 3 vjeç e 4 muaj.



Sa e efektshme është vakcina MMR?

Falë vaksinës MMR pothuajse janë zhdukur 3 sëmundje te fëmijët e vegjël në Mbretërinë e Bashkuar që kur është prezantuar në vitin 1988.

A do të ketë vakcina MMR ndonjë efekt anësor?

3 viruse të ndryshme në vaksinë veprojnë në kohë të ndryshme dhe pas dozës së parë mund të shkaktojnë efektet anësore të mëposhtme:

- 6 deri në 10 ditë pas vaksinimit, ndërsa pjesa e vaksinës për fruthin fillon të punojë, rreth një në 10 fëmijë mund të ketë temperaturë të lehtë dhe disave mund t'u shfaqen disa puçrra të lehta ngjashëm fruthit si dhe nuk kanë oreks
- rreth një në çdo 1000 fëmijë të vaksinuar mund të kenë një krizë që shkaktohet nga temperatura. Ky quhet "konvulsioni febril". Megjithatë, fëmijët që nuk janë vaksinuar dhe që i zë fruthi ka 3 herë më tepër gjasa që të pësojnë një krizë
- rreth 3 javë pas vaksinimit MMR, ndërsa pjesa e vaksinës për shytat fillon të punojë, në raste të rralla disa fëmijë mund të kenë simptoma ngjashëm shytave (temperaturë dhe ënjtje të gjëndrave)

MMR është mënyra më e sigurt për ta mbrojtur fëmijën nga fruthi, shytat dhe rubeola.

- në raste shumë të rralla, fëmijët mund të kenë skuqje ose pika të vogla ngjashëm mavijosjes në 6 javët e para pas vaksinimit. Zakonisht këto shkaktohen nga pjesët e vaksinës për fruthin ose rubeolën. Nëse vini re njolla të tilla, çojeni fëmijën te mjeku për kontroll. Mjeku do t'ju tregojë se çfarë të bëni për puçrrat dhe si ta mbron fëmijën në të ardhmen
- më pak se një në një milion fëmijëve mund t'u shfaqet encefalit (inflamacion dhe ënjtje e trurit) pas vaksinës MMR. Megjithatë, nëse një fëmijë sëmurët me fruth, rreziku i shfaqjes së encefalitit është rreth një në 200 dhe një në 5000

Po nëse fëmija im është alergjik ndaj vezëve?

Vaksina MMR mund t'u jepet në mënyrë të sigurt fëmijëve që kanë pasur alergji të rëndë (reaksion anafilaktik) ndaj vezës. Nëse keni ndonjë merak, flisni me vizitorin e shëndetit, infermierin ose mjekun.

A përmban xhelatinë vakcina MMR?

Në Mbretërinë e Bashkuar kemi 2 vakcina MMR që funksionojnë shumë mirë. Njëra prej tyre përmban xhelatinë derri dhe tjetra jo. Nëse preferoni të merrni vaksinën që nuk përmban xhelatinë derri, flisni me infermierin ose mjekun e përgjithshëm. Mund të shihni fletushkat e informacionit për pacientin lidhur me vaksinën MMR në:

Priorix:

www.medicines.org.uk/emc/product/1159/pil

MMRVAXPRO:

www.medicines.org.uk/emc/product/6307/pil

Jini të vëmendshëm ndaj shenjave të meningjitit dhe septicemisë

Si meningjiti ashtu edhe septicemia janë shumë serioze. Është e rëndësishme të dalloni shenjat dhe simptomat dhe të dini se çfarë të bëni nëse i shihni.

Simptomat e para të meningjitit dhe septicemisë mund të jenë të ngjashme me ato të ftohjes ose gripit (temperaturë, të vjella, irritim dhe nervozizëm).

Megjithatë, personat me meningjit ose septicemi mund të sëmuren shumë rëndë brenda pak orësh, ndaj është e rëndësishme të dini shenjat dhe simptomat e këtyre sëmundjeve.



Çfarë është meningjiti?

Meningjiti është një infeksion i cipës së trurit. Meningjiti mund të shkaktohet nga disa lloje të baktereve ose viruseve.

Infeksioni me bakteret meninjokokale mund të shkaktojë meningjit, septicemi (helmim i gjakut), perikardit (inflamacion i cipës së qeses që vesh zemrën) dhe artrit (ënjtje e kyçeve).

Te foshnjat, simptomat kryesore të meningjtit përfshijnë:

- të qara rënkuese me ton të lartë
- irritim kur merret në krahë
- fryrje në fontanelë
- përgjumje dhe vështirësi në reagim – mezi zgjohet
- i lëshuar dhe i topitur
- i ngurtë me lëvizje të pakontrolluara (konvulsione/kriza)
- nuk ka dëshirë të ushqehet, të vjella
- lëkurë e zbehtë, me njolla ose ngjyrë blu
- temperaturë

Çfarë është septicemia?

Septicemia është një sëmundje shumë e rëndë që ndodh kur infektohet gjaku. Shenjat e duarve dhe këmbëve të ftohta, lëkurës së zbehtë, të vjellave dhe përgjumja ose vështirësia për t'u zgjuar mund të shfaqen shpejt. Nëse dyshoni për septicemi, kërkoni ndihmë urgjente.

Te foshnjat, simptomat kryesore të septicemisë mund të përfshijnë:

- ritëm i shpejtë ose i pazakontë i frymëmarrjes
- lëkurë e zbehtë, me njolla ose ngjyrë blu
- temperaturë me duar dhe këmbë të ftohta
- dridhja
- të vjella dhe nuk pranon të ushqehet
- njolla të kuqe ose vjollcë që nuk zbehen kur shtypen (bëni testin e gotës që shpjegohet në faqen vijuese)*
- dhimbje ose irritueshmëri nga dhimbjet muskulore ose dhimbje të forta të gjymtyrëve ose kyçeve
- topitje
- përgjumje e rëndë

Është e rëndësishme të mbani parasysh se jo të gjithëve u shfaqen të gjitha simptomat që përmenden, dhe se kjo listë e simptomave nuk është shteruese. Nëse një personi i shfaqen këto simptoma, sidomos njollat e kuqe ose vjollcë, kërkoni ndihmë mjekësore urgjente. Nëse nuk mund të lidheni me mjekun, ose nëse vazhdoni të jeni në merak edhe pasi keni marrë këshilla, besojuni instinkteve dhe çojeni fëmijën te urgjenca ose te spitali më i afërt.

* Në lëkurë të errët, kontrolloni pjesën e brendshme të kapakëve të syve ose pjesën e sipërme të gojës ku njollat mund të jenë më të dukshme

Testi i gotës

Shtypeni anën e një gote transparente pas puçrrës që të shihni nëse puçrra zbehet dhe e humbet ngjyrën gjatë shtypjes. Nëse nuk e ndryshon ngjyrën, kontaktoni menjëherë mjekun.



Ku mund të marr më shumë informacion?

Këto organizata bamirësie japin informacion, këshilla dhe ndihmë:

Meningitis Research Foundation

Linja telefonike falas 080 8800 3344
(09:00 deri në 22:00 në ditët e javës,
10:00 deri në 20:00 në fundjava dhe në ditët e
pushimeve) www.meningitis.org

Meningitis Now

Linja telefonike 24-orëshe
0808 8010 388
www.meningitisnow.org

Gjithashtu mund të pyesni mjekun, infermierin ose vizitorin e shëndetësisë për këshilla, ose mund të telefononi **NHS** në **111**.

Prindërit dhe kujdestarët mund t'i raportojnë dyshimet për efektet anësore të vaksinave dhe barnave nëpërmjet Yellow Card Scheme.



Kjo mund të bëhet online duke vizituar **yellowcard.mhra.gov.uk** ose duke telefonuar linjën e Yellow Card në **0800 731 6789**. Gjithashtu mund të përdorni kodin QR ose mund të shkarkoni aplikacionin Yellow Card.

Programi i vaksinimit të zakonshëm për fëmijët nga shtatori 2024

Mosha kur duhet	Sëmundjet nga të cilat mbrohem	Vaksinat që bëhet
Tetë javësh	Difteria, tetanosi, pertusis (kolla e mirë), poliomieliti, <i>Haemophilus influenzae</i> tipi b (Hib) dhe hepatiti B	DTaP/IPV/Hib/HepB
	Meninjokokal grupi B (MenB)	MenB
	Gastroenteriti Rotavirus	Rotavirus ²
Dymbëdhjetë javësh	Difteria, tetanosi, pertusis (kolla e mirë), poliomieliti, Hib dhe hepatiti B	DTaP/IPV/Hib/HepB
	Pneumokokale (13 serotipe)	Vaksina e konjuguar pneumokokale (PCV)
	Rotavirus	Rotavirus ²
Gjashtëmbëdhjetë javësh	Difteria, tetanosi, pertusis (kolla e mirë), poliomieliti, Hib dhe hepatiti B	DTaP/IPV/Hib/HepB
	MenB	MenB
Një vjeç (në ose pas ditëlindjes së parë të fëmijës)	Hib dhe MenC	Hib/MenC
	Pneumokokale	Vaksinë përforcuese PCV
	Fruthi, shytat dhe rubeola (fruthi gjerman)	MMR
	MenB	Vaksinë përforcuese MenB
Grupmoshat e përshtatshme pediatrike ⁴	Gripit (çdo vit nga shtatori)	Vaksina e gjallë e atenuar e gripit LAIV ^{3,6}
Tre vjeç e katër muaj ose menjëherë pas kësaj moshe	Difteria, tetanosi, pertusis dhe poliomieliti	dTaP/IPV
	Fruthi, shytat dhe rubeola	MMR (kontrolloni dozën e parë të dhënë)
Djemtë dhe vajzat e moshës dymbëdhjetë deri në trembëdhjetë vjeç	Kanceret dhe lythat gjenitale të shkaktuara nga lloje specifike të papillomavirusit të njeriut (HPV)	HPV ⁵
Katërmëdhjetë vjeç (klasa e 9-të)	Tetanosi, difteria dhe poliomieliti	Td/IPV (kontrollo statusin e MMR-së)
	Grupet meninjokokale A, C, W dhe Y	MenACWY

[1] Injektiv ndërmuskulor në muskulin deltoid në pjesën e sipërme të krahut ose në aspektin anterolateral të kofshës. **[2]** Vaksina e Rotavirusit duhet të bëhet vetëm pasi të ketë kontrolluar rezultati i ekzaminimit për SCID. **[3]** Përmban xhelatinë derri. **[4]** Shiko letrën vjetore për gripin: www.gov.uk/government/collections/annual-flu-programme. **[5]** Shiko Green Book HPV Kapitulli 18a për hollësi lidhur me vaksinimin e të rinjve me sistem imunitar të kompromentuar të cilët do të kenë nevojë për 3 doza. **[6]** Nëse LAIV (vaksina e gjallë e dobësuar kundër gripit) nuk rekomandohet ose është e papërshtatshme, përdorni vaksinën e çaktivizuar kundër gripit (kontrollo Green Book Kapitulli 19 për hollësi). **[7]** Shiko Green Book Shingles Kapitulli 28a për hollësi lidhur me grupmoshat që kualifikohen, duke përfshirë personat me sistem imunitar shumë të dobët nga mosha 50 vjeç.

Vaksinat shitesë për individët me probleme shëndetësore ekzistuese

Gjendja shëndetësore	Sëmundjet nga të cilat mbrohem	Vaksinat që nevojiten ¹
Asplenia ose mosfunksionimi i shprehës (përfshirë për shkak të qelizave drapër dhe sëmundjes celiake)	Grupet meningokokale A, B, C, W dhe Y Pneumokokale Gripit	MenACWY MenB PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Vaksina vjetore e gripit
Implantet kokleare	Pneumokokale	PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç)
Sëmundjet kronike të frymëmarrjes dhe zemrës (të tilla si astma e rëndë, sëmundja pulmonare kronike dhe infarkti)	Pneumokokale Gripit	PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Vaksina vjetore e gripit
Sëmundjet neurologjike kronike (të tilla si sëmundja e Parkinsonit ose e neuroneve motorike, aftësitë e kufizuara në të mësuar)	Pneumokokale Gripit	PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Vaksina vjetore e gripit
Diabeti	Pneumokokale Gripit	PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Vaksina vjetore e gripit
Sëmundja kronike e veshkave (CKD) (duke përfshirë hemodializën)	Pneumokokale (faza 4 dhe 5 CKD) Grupi (faza 4 dhe 5 CKD) Hepatitis B (faza 4 dhe 5 CKD)	PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Vaksina vjetore e gripit Hepatitis B
Sëmundjet kronike të mëlçisë	Pneumokokale Gripit Hepatitis A Hepatitis B	PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Vaksina vjetore e gripit Hepatitis A Hepatitis B
Hemofilia	Hepatitis A Hepatitis B	Hepatitis A Hepatitis B
Imuniteti i dobët për shkak të sëmundjeve ose trajtimeve ⁴	Pneumokokale Vaksina e herpesit Gripit	PCV13 (deri në 10 vjeç) ^{2,3} PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Shingrix – PCV13 deri në 50 vjeç ⁵ Vaksina vjetore e gripit
Çrregullimet e komplementit (përfshirë ata që marrin terapi me frenues të komplementit)	Grupet meningokokale A, B, C, W dhe Y Pneumokokale Gripit	MenACWY MenB PCV13 (deri në 10 vjeç) ² PPV23 (nga moshë 2 vjeç) Vaksina vjetore e gripit

[1] Shihni kapitullin përkatës të Green Book për programin specifik: www.gov.uk/government/collections/immunisation-against-infectious-disease-the-green-book. [2] Nëse fëmija është nga 2 vjeç deri në 10 vjeç dhe nuk është vaksinuar ose është vaksinuar pjesërisht kundër infeksionit pneumokokal, bëni një dozë PCV13. [3] Për çdo moshë me sistem imunitar të dobët. [4] Merrni në konsideratë vaksinimin për pjesëtarët e familjes dhe për personat që kujdesen për njerëzit me këto probleme shëndetësore. [5] Shihni Green Book Shingles Kapitulli 28a www.gov.uk/government/publications/shingles-herpes-zoster-the-green-book-chapter-28a.

Programi i vaksinimit selektiv të fëmijëve

Grupi i synuar	Mosha dhe programi	Sëmund-ja	Vaksinat që nevojiten
Foshnjat e lindura nga nënat e infektuara me hepatitin B	Në kohën e lindjes, katër javë e 12 muajsh ^{1,2}	Hepatiti B	Hepatiti B (Engerix B/ HBvaxPRO)
Foshnjat në zonat e vendit që kanë raste të TB >= 40/100.000	Rreth 28 ditësh ⁴	Tuberkulozi	BCG
Foshnjat me një prind ose gjysh të lindur në një vend me numër të lartë rastesh ³	Rreth 28 ditësh ⁴	Tuberkulozi	BCG
Fëmijët në një grup rreziku klinik	Nga 6 muaj deri në 17 vjeç	Gripit	LAIV ose vakcina e gripit të çaktivizuar nëse nuk rekomandohet për LAIV ose nën moshën 2 vjeç
Gratë shtatzëna	Në çdo fazë të shtatzënisë gjatë sezonit të gripit	Gripit	Vakcina e çaktivizuar kundër gripit
	Nga java e 16-të e shtatzënisë ⁵	Pertusis	Tdap ose dTaP/IPV
	Nga java e 28-të e shtatzënisë	RSV	Vakcina e RSV

[1] Merrni gjak për HBsAg në moshën 12 muajshe për të përjashtuar rrezikun e infeksionit. [2] Përveç vaksinës hegzavalente (Infanrix hexa ose Vaxelis) bëhet në moshën 8, 12 dhe 16 javëshe. [3] Në vendet ku rastet e TB janë >= 40/100.000 – shihni www.gov.uk/government/publications/tuberculosis-tb-by-country-rates-per-100000-people. [4] Kontrolloni rezultatin e ekzaminimit të SCID para se të jepni BCG. [5] Është mirë të bëhet para javës 32 të shtatzënisë, megjithatë mund të jepet edhe pas 32 javëve.



Produced by
UK Health Security Agency

© Crown copyright 2024
2024QG1AL Albanian 1p 500K AUG 2024
UK Health Security Agency Numri i gateway: 2024493

Ky numër është botuar për herë të parë në dhjetor 2019.
Nëse keni nevojë për më shumë kopje të kësaj fletushke, ju lutemi vizitoni, www.healthpublications.gov.uk për të kontaktuar linjën e Health Publications. Ph1: 0300 123 1002. Minicom: 0300 123 1003 (08:00 deri në 18:00, nga e hëna në të premte).
Ju lutemi përdorni kodin e produktit: 2024QG1AL Albanian